

LIGJ
Nr. 104/2018

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9374, DATË 21.4.2005, “PËR NDIHMËN
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Përfshirja nga përfitimi i ndihmës shtetërore

1. Subjekti përfshirë nga përfitimi i ndihmës shtetërore nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Përfshirja nga përfitimi i ndihmës shtetërore zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i subjektit përfitues të ndihmës, në kuptim të këtij ligji, aksionar ose ortak i tij, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve për të përfituar ndihmën shtetërore, subjekti përfitues i ndihmës duhet të paraqesë vërtetim mbi gjendjen gjyqësore, ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.12.2018

Shpallur me dekretin nr. 11008, datë 18.12.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta